



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-8150 /25

Klinë, dt: 21.03 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja I e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 09.01.2025, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti nënkryetaren e komunës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, drejtorin e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, z. Enver Berisha, drejtorin e Administratës, z. Binak Sylaj, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

Komiteti për Politikë dhe Financa, përveç pikave të parapara në rendin e ditës, shqyrtoi dhe rekomandoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend:

-Shqyrtimin e Draft- Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2030.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e II-të e mbajtur me qytetarë nga kryetari i komunës për vitin 2024;
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-dhjetor 2024;
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt dhjetor 2024- janar 2025;
6. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Kjo është mbledhja e parë për këtë vit e Komitetit për Politikë dhe Financa. Unë ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj një fillimvit të mbarë. Po besoj se edhe sot kemi marr material, pasi jua kemi shpërndarë fizikisht edhe raportin financiar dhe prezent jemi të gjithë. Kështu që, mund të vazhdojmë me mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, duke propozuar fillimisht që në rend të ditës të shtohet edhe një pikë me kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit, që është Plani Lokal i Veprimit në Mjedis. A ka dikush? Kush është për?

Me 7 vota PËR u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Jemi të gjithë të pranishëm.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: Kush është për miratim të këtij procesi?

Me 7 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e II-të e mbajtur me qytetarë nga kryetari i komunës për vitin 2024.

-Kryesuesi theksoi se, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kemi obligim ligjor për shqyrtimin e këtij procesverbali nga takimi i mbajtur me qytetarët nga kryetari i komunës për rrjedhat qeverisëse, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të procesverbalit nga takimi i dytë i mbajtur me qytetarë nga kryetari i komunës, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4 . Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-dhjetor 2024.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe

Zhvillim, i cili theksoi se: Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2024 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Buxheti për vitin 2024 ka qenë 15,866,596.94 euro.

Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, shënuan shpenzimin prej 8,092,428.93€; Shpenzimet në mallra dhe shërbime gjatë kësaj periudhe janar-dhjetor 2024, shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 1,761,911.68 €; Shpenzimet në komunal, gjatë kësaj periudhe janar-dhjetor, shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 269,996.78 €; Shpenzimet në subvencione dhe transfere, shënuan shumën prej 679,856.95 € gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 dhe; Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 4,605,207.02 €.

Buxheti i shpenzuar në periudhën janar-dhjetor 2024 në shumën prej 15,409,401.36 € është 97.12 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me shumën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2024. Po ashtu, kërkesë e Drejtorisë për Financa ishte bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake dhe ndarja e një shume të mjeteve financiare për pagesën e shujtës ditore në vlerë prej 4 euro për vitin 2024 për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit të Menaxhimit Financiar janar-dhjetor 2024, me 7 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Po ashtu, lidhur me kërkesën për bartjen e mjeteve financiare nga tejkalimi i buxhetit nga të hyrat vetanake, me 7 vota PËR, u rekomandua që nëse deri në seancë arrin të përfundojë procesi i regjistrimit në thesar, të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend dhe të ndahen mjetet financiare për pagesën e shujtës sipas propozimit të Ekzekutivit.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt dhjetor 2024- janar 2025.

Kërkesa 1.

Kërkesë nga Drejtoria e Bujqësisë për shtim të buxhetit nga participimi i qytetarëve për projektin “Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë Motokultivator me Freza” në vlerë prej 11.802.00 euro.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për shtim të buxhetit nga participimi i qytetarëve lidhur me projektin për shpërndarjen e Motokultivatorëve me Frez, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga OVL e UÇK-së, dega në Klinë, me anë të së cilës kërkojnë nga Komuna e Klinës që të ndërmarrë masa lidhur me pagesën e luleve të cilat janë marrë nga organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së për homazhe gjatë vitit 2024.

Fadil Gashi, Kryesues: Po, drejtor, z.Binak Sylja?

Binak Sylja, drejtor i Administratës: Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetaren dhe gjithë ju të pranishëm! Unë e pash kërkesën e OVL-UÇK-së dhe ata kanë të drejtë në kërkesën e tyre, por nuk e di sa qëndron kjo, pasi menaxheri aktual i kontratës është ndryshuar dhe operatori i kaluar ka përfunduar mandatin. Ne e kemi informuar me kohë se duhet të furnizohemi me operatorin e ri ekonomik. Nuk e di kjo pse ka ndodhur kështu, megjithatë, është çështje që jemi para një situatë të tillë se e kanë marrë materialin, por duhet ta gjejmë formën. Ne kemi diskutuar edhe në bord me Drejtorinë e Kulturës për të gjetur një mundësi, pasi që ata nuk kanë mundësi t'i bëjnë ato pagesa për shkak se sigurisht është një shumë që ata janë furnizuar gjatë krejt vitit kalendarik.

Mendoj që është obligative dhe e detyrueshme nga ekzekutivi që drejtori i Kulturës të bisedojë haptazi me shoqatën dhe të gjejë një mundësi të përbashkët se si të vazhdojmë tutje. Sigurisht që ata nuk mund t'i paguajmë, duhet të gjejmë formën, por forma reale duhet me qenë e atillë që nuk penalizohet nga auditorët. Kjo është ajo çka kemi diskutuar edhe në ekzekutiv dhe mendoj që kjo ka për të ndodhur shumë shpejtë. Është caktuar përgjegjësi, drejtori i Kulturës, që të bisedojë me shoqatat dhe ta gjejë mënyrën se si mund të realizohet kjo pagesë. Faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, a ka dikush?

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues! Nëse mund ta dimë sa është shuma?

Binak Sylja, drejtor i Administratës: Nuk e di saktë, diku rreth 500 euro.

Tunë Deda: Desha ta di, a ka qenë operatori i ri i gatshëm për t'i dhënë ato lule, ato kurora? Pse nuk kanë shkuar këta t'i marrin te i riu, por te i vjetri?

Fadil Gashi, kryesues: Sigurisht ka qenë mungesë e informacionit, moskomunikim dhe mosinformim. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së OVL-së, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të gjendet një zgjidhje për pagesë.

Kërkesa 3.

Kërkesë e parashtruar nga tri organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, dega në Klinë, me anë të së cilës kërkojnë nga Komuna e Klinës që të bëjë renovimin e sheshit "Mujë Krasniqi" pasi që po vazhdon të dëmtohet.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së OVL-së, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Kërkesa 4.

Kërkesë nga Armend Gjemajlaj, i cili kërkon nga Kuvendi Komunal dhe Komiteti për Politikë dhe Financa që të ja mundësojë shfrytëzimin e hapësirës publike të Parcelës nr.P-71006024-00495-3, pronë e Komunës së Klinës, në sipërfaqe prej 450 m² (4.5 ari) duke u bazuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të pronës komunale.

Thekson: pasi që jetoj së bashku me vëllezërit dhe kemi dy shtëpi të ndërtuara afër parcelës në fjalë, planifikoj të investojë një kënd të lojërave për fëmijë e që do të shfrytëzohet nga fëmijët e tij dhe të lagjes. Pasi që parcela në hapësirë prej 450 m² është hapësirë e mjaftueshme afër shtëpisë ku banoj unë dhe i kam mundësitë për investime, pagesën për shfrytëzimin e hapësirës publike e bëj duke u bazuar në rregulloret në fuqi.

Në momentin kur Komuna parasheh të ndërtojë apo ta shfrytëzojë për nevoja të saj, unë si qytetar, obligohem ta liroj hapësirën dhe mbetet në shfrytëzim të Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga z. Armend Gjemajlaj për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit, ku do të veprohet sipas Ligjit Nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 5.

Kërkesë e parashtruar nga Hazir Jakupi i cili thekson se: unë, vëlla i dëshmorit të kombit Fitim Jakupi, kërkoj që ne si familje të na lejohet ndërtimi i lapidarit të dëshmorit të kombit Fitim Jakupi në Caravik, pranë varrit të tij.

Toka ku është i vendosur varri i dëshmorit dhe ku kemi planifikuar ndërtimin e lapidarit ndodhet në fshatin Caravik dhe është pronë publike komunale, parcela me numër 00149-0. Po ashtu, kjo parcelë është pranë parcelës time me numër 00167-0.

Ndërtimi i lapidarit do të bëhet me mjete financiare të familjes dhe nuk kemi nevojë që komuna të bashkëfinancojë apo të ndihmojë në këtë aspekt.

Ndërtimi i këtij lapidari bëhet me pëlqimin e bashkëfshatarëve, ku bashkëngjitur i gjeni edhe nënshkrimet e tyre, kryesisht kryefamiljarëve, të cilët kanë shprehur pajtimin e tyre që ky lapidar të ndërtohet.

Kërkesa 6.

Kërkesë e parashtruar nga Ilir Ibishaj nga fshati Caravik, me anë të së cilës kundërshtohet kërkesa e parashtruar nga Hazir Jakupi nga fshati Caravik, me anë të së cilës është kërkuar lejimi i ndërtimit të lapidarit për dëshmorin Fitim Jakupi, në parcelën me nr. 00149-0 e cila është pronë e komunës së Klinës.

Arsyeja e kundërshtimit të vendosjes së lapidarit për dëshmorin Fitim Jakupi, sipas kërkesës së parashtruar nga Ilir Ibishaj, është sepse qëllimi i lagjes "Rudat" është fillimisht vendosja e lapidarit dhe më pas vendosja e varrezave të reja në parcelën me nr. 00149-0 e cila gjendet fare pranë shtëpive të lagjes "Ibishaj" dhe po ashtu afër shkollës së fshatit.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Hazir Jakupi për lejimin e vendosjes së lapidarit për dëshmorin Fitim Jakupi dhe pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Ilir Ibishaj për moslejimin e vendosjes së lapidarit për dëshmorin Fitim Jakupi, me 7 vota PËR, rekomandoi që dy kërkesat të dërgohen për shqyrtim në Drejtorinë e Inspektoratit, Inspektorati të bëjë një raport në lidhje me këtë çështje dhe ta informojë Kuvendin.

Pika 6. Shqyrtimi i Draft- Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2030 dhe Raporti nga procesi i dëgjimit publik lidhur me këtë plan.

Fadil Gashi, kryesues: Po ja kaloj fjalën, znj. Xhezide Trepça-Gashi.

Xhezide Trepça-Gashi: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për të gjithë! Ne, si grup punues prej 11 anëtarëve, gjatë muajit nëntor dhe dhjetor e kemi hartuar Draft Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Meqenëse prej vitit 2015 nuk ka komuna Plan Lokal të Veprimit në Mjedis, ne si Drejtori e Urbanizmit, së bashku me drejtori të tjera, e kemi hartuar dhe përfunduar këtë draft plan. Në këtë kërkesë është i bashkangjitur edhe raporti i shqyrtimit publik. Gjitha procedurat janë kryer, drafti është përfunduar, prandaj kemi bërë kërkesë që kjo pikë të futet në rendin e ditës në seancën e janarit që të miratohet nga asambleja komunale. Kërkesa ndoshta mund të jetë bërë pak më vonë, prandaj kemi kërkuar që të futet në pikën të ndryshme. Faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, a ka dikush tjetër? Urdhëro, Tunë!

Tunë Deda: Po, faleminderit shumë! Unë sa munda ta shoh është krejt në rregull kjo, por a keni bërë ndonjë plan veprimi për t'i hequr ato mbetje inerte, duke gjetur një zgjidhje të përhershme për t'i larguar?

Marqe Tanushi-Selmanaj: Pasi kam qenë pjesë e grupit punues, e di që Xhezidja e ka kryer punën më të madhe. Prioritete mjedisore për periudhën 2024 -2029, dmth plani ishte pesëvjeçar, por për shkak të kohës që ishte në fund të vitit e kemi bërë 2025-2030. Janë faktikisht 23 prioritete edhe nëse e sheh listën janë paraparë gjitha: duke filluar prej përmirësimit të

mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zonës urbane me qëllim zvogëlimin të humbjeve, grumbullimi i mbetjeve të ndryshme, përfshirë edhe ato të forta, ndërtimi i një rezervuari në fshatin Çabiq, përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në lagje të zonave urbane, investimet në fabrikën e ujit dhe gjithsej janë 23 veprimtari ose thjesht objektiva të cilat janë paraparë në këtë plan të veprimit. Ajo që është më kryesorja në këtë plan pesëvjeçar është vizioni që ka për qytetin tonë: një komunë e gjelbër, e qëndrueshme dhe e zhvilluar, ku turizmi, biodiversiteti dhe burimet natyrore ndërrohen, ndotja minimizohet, dhe komuniteti angazhohet vazhdimisht për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Kjo është ajo përgjigja që ti e the për grumbullimin e mbeturinave dhe janë të parapara dhe të menduara në detaje. Janë proceset dhe kohët kur kanë me u zhvilluar dhe është e paraparë me buxhet.

Tunë Deda: Faleminderit, nënkryetare! Unë e pash çka keni paraparë ju, por çka keni planifikuar për të ndërmarrë dhe për të kryer punën? Se aty duhet të parashihet që komuna të ketë një kamion dhe 4-5 punëtorë që t'i heqin mbetjet çdo ditë, sepse qytetarët nuk kanë ku t'i hedhin mbetjet dhe i hedhin ku është më lehtë. Nuk ka fshat që nuk ka një depo të atyre mbetjeve inerte, për atë ne duhet të gjejmë një zgjidhje, duke blerë një kamion komunë dhe duke punësuar 4 -5 punëtorë, se ka para dhe mundësi, dhe duhet ta gjejmë mënyrën për ta realizuar këtë.

Marqe Tanushi-Selmanaj: Faleminderit shumë! Faktikisht, këtë temë e kemi diskutuar dhe e kam dëgjuar vetë nga kryetari, i cili ka bërë një projekt së bashku me drejtoritë përkatëse që është në proces e sipër blerja ose sigurimi i një mjeti bartës për këto mjete, dhe sigurisht që kjo ka për të ndodhur. Pjesa tjetër e punësimit të punëtorëve ndoshta do të jetë riaktivizimi i këtyre që janë për punësim, nuk e kam të sigurtë, por për automjetin që do të bëjë grumbullimin e mbetjeve jam e sigurt që do të ndodhë shumë shpejt, sipas kryetarit që ne kemi diskutuar bashkë në lidhje me këtë temë.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit! Po, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues! Edhe unë desha të ndërlidhem me kolegun. Po, është e vërtetë kjo, se unë i shoh për shembull shumë qytetarë që i gjuajnë mobilet në çdo vend edhe ata p.sh. duhet të kenë një pikë të caktuar ku t'i hedhin këto mbetje, duhet t'u mundësojmë një vend grumbullimi dhe adresimi për këto mbetje. Po ashtu, desha të ndërlidhem te pika 9 sa për sqarim; në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë duhet të shkarkohen ujërat e zeza. A keni paraparë me u shkarkuar në lumë? Se nuk e kam të qartë, a mund të më jepni një sqarim?

Marqe Tanushi-Selmanaj: Faleminderit shumë për pyetjen! Aq sa unë kam informacion, aq sa edhe ju, është e dënueshme dhe e patolerueshme, dhe jam shumë e sigurt që është keqformulim ose gabim teknik. Përndryshe, nuk është e lejueshme dhe nuk do të ndodhë që këto direkt të hidhen në lumë. Plani i veprimit për mbrojtje të ambientit, pikërisht synim i ka t'i ndalojë këto ndotje në lumenj dhe natyrë. Sigurisht që nuk do ta kishim paraparë me plan, që këto ujëra të zeza të shkarkohen në lumë, jam shumë e sigurt. Por, ndoshta formulimi i pikës së madhe, ku qëndrojnë objektivat, është i paqartë ose mungon termi i përshtatshëm, se këtu duhet të ketë ndryshime. Këtu do të bëhet më e mira lidhur me këtë draft, kur të finalizohet. Ky është draft që do të kalojë në plan, dhe për këtë arsye do të kalojë në diskutim me qytetarë, të marrim vërejtjet,

sugjerimet e tyre për të shërbyer më mirë qytetarët e komunës së Klinës në pesë vitet e ardhshme.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, nënkryetare! A ka dikush tjetër? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Draft- Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2030 dhe Raportit nga procesi i dëgjimit publik, me 7 vota PËR, rekomandoi që Raporti nga procesi i dëgjimit publik të kalojë për shqyrtim në Kuvend, ndërsa Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2025-2030 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 7. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush në të ndryshme? Atëherë, faleminderit shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim, shihemi në takimin e radhës!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

